

# **BUSINESS** **NEWS**

janar - dhjetor 2024



**RRUGA DREJT SUKSESIT**

Nga Vasil Naçi

Tashmë në edicionin e tij të 9-të, Rruga Drejt Suksesit vijon të bashkojë dhe fuqizojë komunitetin e njerëzve që aspirojnë dhe investojnë tek zhvillimi personal dhe profesional, me synim arritjen e suksesit të vazhdueshëm.



**MJESHTËRO BIZNESIN**

Nga Vasil Naçi

"Mjeshtëro Biznesin" një ngjarje e bukur, me 1000 të pranishëm, sipërmarrës, drejtues, profesionistë, studentë dhe apsirantë nga bota e biznesit, në tre ditë dedikuar suksesit në biznes.



**GLINA**

Xhevahir i rrallë i natyrës shqiptare!

Glina, 50 vjet histori. Mbrëmje gala në Pallatin e Kongreseve.

**ELBAR "MONDE SELECTION GOLD AWARD"**

Krenari Shqiptare!

Birra shqiptare Elbar fiton MEDALJEN E ARTË në konkursin ndërkombëtar "Monde Selection 2024".



**COLOR DAY FESTIVAL**

Më shumë se 60.000 të rinj shijuan energjinë e këtij festivali, duke e bërë këtë ditë një festë të paharrueshme.



**HEINEKEN**

Shpërblen konsumatorët me një experiencë fantastike në ndeshjen gjysmë finale të UEFA Champions League, Real Madrid vs. Bayern Munchen.

**LOTARIA DUEL**

Një fushatë promovionale e suksesshme nga Duel, ku konsumatorët besnikë u shpërblyen me dhurata fantastike.



**E**dhe këtë vit ashtu siç është bërë tashmë traditë, Rruga drejt Suksesit u organizua në muajin nëntor në një atmosferë plot energji me mbi 1300 pjesëmarrës në ambientet e Expo City, Tiranë.

Tashmë në edicionin e tij të 9-të, Rruga Drejt Suksesit' vijon të bashkojë dhe fuqizojë komunitetin e njerëzve që aspirojnë dhe investojnë tek zhvillimi personal dhe profesional, me synim arritjen e suksesit të vazhdueshëm. "Suksesi nuk është rastësor, nuk është një ngjarje, por shumatore e mendimeve, vendimeve, veprimeve, zakoneve dhe disiplinës tuaj." -theksoi Vasili gjatë eventit.

Me mbi 33 vite suksese, eksperiencia, sfida dhe përpjekje të vazhdueshme për të krijuar një biznese të suksesshme, Vasili vijon të sjellë më të mirën e rrugëtimit të tij shumëvjeçar, përditësuar me të rejtat më të fundit, të përmbledhura në një formulë për sukses. Ai beson se rruga drejt suksesit kërkon kujdes të veçantë në kultivimin e energjisë, mendësisë dhe sistemeve të duhura që hedhin bazat për rritjen personale.

Të gjithë mendojnë dhe kërkojnë suksesin, por asgjë nuk ndodh nëse mendimet nuk ndiqen nga veprimet. Pikërisht për të ushqyer këtë qasje event-trajnimi "Rruga Drejt Suksesit" orientohet jo vetëm kah dhënies së mesazheve të fuqishme, por edhe në stimulimin e reflektimit dhe ndërveprimit të pjesëmarrësve, si dhe në zhvillimin e planeve të tyre

individuale për sukses, gjatë ditëve të eventit. Ndaj në sallën e tejmbushur ku atmosfera energjdhënëse ndihet lehtësisht, të pranishmit morën pjesë në mënyrë aktive në ushtrimet që nxitën projektimin drejt të ardhmes, kuptimin e sistemeve dhe planifikimin e veprimeve të nevojshme për sukses.

Mbështetur në materiale studimore dhe në eksperiencia të ndryshme Vasili solli shembuj se si mendësia, zakonet dhe përmirësimi i përditshëm, formëson strukturën e suksesit individual. Me moton: "Besimet dhe veprimet tuaja të vullnetshme do të përcaktojnë atë që do mund të arrini", Vasili nxiti pjesëmarrësit të zëvendësojnë besimet kufizuese me ato fuqizuese, si pjesë e procesit transformues dhe fuqizues që eventit 'Rruga Drejt Suksesit' ka si objektiv të realizojë.

Në përfundim të eventit, pjesëmarrësit kishin vendosur veten në një trajektore të rritjes personale dhe profesionale, të vetëdijshëm që sukcesi nuk është një destinacion, por një udhëtim i rritjes së vazhdueshme.

Dinamika e eventit, njohuria dhe praktikatat që garantojnë sukses, kombinuar me energjinë e jashtëzakonshme dhe miqësitë e reja mes njerëzve që duan suksesin, do të shoqërojnë pjesëmarrësit në udhëtimin e tyre drejt një viti të ri kalendari, plot sfida dhe mundësi për të vendosur dhe realizuar objektivat dhe dëshirat e tyre.

## RRUGA drejt SUKSESIT

nga VASIL NAÇI



**E**vent-trajnitimit "Mjeshtëro Biznesin" 2024 ishte një ngjarje e bukur, me 1000 të pranishëm, sipërmarrës, drejtues, profesionistë, studentë dhe apsirantë nga bota e biznesit, në tre ditë dedikuar suksesit në biznes.

"Mjeshtëro Biznesin" është shndërruar ndër vite në një pikë takimi dhe moment të domosdoshëm reflektimi, vetëdijësimi dhe ndërmarrje hapash të rinj, për këdo që synon të jetë i suksesshëm në botën e biznesit.

Në botën e sotme të biznesit, plot konkurrencë, pasiguri, kriza dhe sfida, vazhdimisht në ndryshim dhe inovim, të gjithë ata që duan suksesin, kanë nevojë për shumë se kurrë të përshtaten, të mësojnë dhe të investojnë tek dija. Kështu mund të bëjnë përpara qoftë investitori me përvojë, sipërmarrësi fillestar apo profesionisti korporativ. Pavarësisht fazës së udhëtimit të tyre në botën e biznesit, çelësi i rritjes dhe suksesit afatgjatë qëndron tek njohuritë, mjetet, strategjitë e duhura, për të nxitur veprime të fuqishme e të suksesshme.

Në biznes çdo element është jetik për suksesin, që nga qartësia e vizionit dhe strategjive tek fryma e lidershit dhe skuadrat efikase, nga mjeshtërimi i marketingut dhe brandit tek standardizimi dhe optimizimi i proceseve të shitjes, nga gjenerimi dhe shfrytëzimi i mundësive të inovacionit tek fuqia e analizave financiare dhe investimeve afatgjata.


Pikërisht ky premtim i mbajtur është "Mjeshtëro Biznesin". Një event me një program të plotë dedikuar suksesit në biznes, si një mundësi për komunitetin e biznesit në Shqipëri dhe rajon për t'u mbledhur, mësuar dhe zhvilluar, e për të përparuar drejt sfidave dhe sukseseve të reja.

Pjesëmarrësit përfituan më të mirën e përvojës dhe dijeve të Vasil Naçit, si dhe të skuadrës së ekspertëve që ai kishte ftuar në event: Prof. Dr. Rezarta Shkurti (Perri), Dr. Alma Bici, Ermal Sadiku dhe Arti Marko, të cilët trajtuan tema të rëndësishme për sukses në biznes.

Ndër të tjera pjesëmarrësit morën përgjigje për pyetje apo sfida si:

- Si të krijojnë, konsolidojnë dhe të përmirësojnë strategjinë e biznesit?
- Si të krijojnë dhe të kujdesemi për brande të dashura për konsumatorët?
- Si të rrisin shitjet dhe optimizojnë sistemet e menaxhimit të tyre?
- Si të përdoret fuqia e analizave financiar për zhvillimin e biznesit?
- Si të dominojnë në biznes falë teknologjisë dhe inovacionit?





# Glna

## xhevahir i rrallë i natyrës shqiptare!

### 50 VITE HISTORI SUKSESI



**U**ji natyral mineral Glna festoi në një mbrëmje gala në Pallatin e Kongreseve 50 vjet histori.

Nën drejtimin e Ardit Gjebreas, regji të Aldon Lipes dhe skenar të Kozeta Kurtit, udhëtimi në kohë i Glinës, brandit më të vjetër shqiptar, erdhi përmes një koncerti artistik me muzikë të përzgjedhur shqiptare të këtyre 50 viteve.

Miq dhe të ftuar ndanë histori e kujtime me ujin Glna, ndërsa studiues të vlerave kurative të tij, risollën fakte shkencore të aprovuara nga shumë kongrese mjekësore që tregojnë ndër vite vlerat e rralla kurative, ç'ka e bëjnë Glinën një mrekulli të natyrës shqiptare.

Uji Glna, me përmbajtje unike minerale dhe kaq i dashur për të gjithë, bëri bashkë krejt natyrshëm disa prej artistëve me të mirë të skenës si Petrit Lulo, Liljana Kondakçi, Bashkim Alibali, Rona Nishliu, Anxhela Peristeri, West Side Family, Martin Pano, e talentuara Armina e vogël dhe me pjesëmarrjen ekskluzive të artistes Mira Konçi, e cila erdhi nga SHBA posaçërisht për 50 vjetorin e Glinës.

Festa e 50 vjetorit ishte një udhëtim i bukur në kohë, ku këngët që kanë bërë histori, u shoqëruan me fakte e informacione domethënëse për jetën ndër vite në Shqipëri, në kohëra të bukura e të vështira, ku edhe Glna ka shënjuar momentë të bukura, kuptimplota jo thjesht si një ujë, por si një bashkëudhëtare jete me njerëzit, si pjesë e gjithë tryezave të tyra familjare, në halle e gëzime, duke na bërë të gjithëve krenarë.

**Për shumë vjet gëzuar nga Glna!**

# KRENARI SHQIPTARE

## ELBAR, BIRRA SHQIPTARE QË NA BËN KRENAR!

**B**irra shqiptare Elbar fiton MEDALJEN E ARTË në konkursin ndërkombëtar Monde Selection 2024.

Birra shqiptare Elbar, ka fituar MEDALJEN E ARTË në konkursin prestigjioz ndërkombëtar Monde Selection 2024, i organizuar këtë vit në Vjenë, Austri. Ky çmim i rëndësishëm iu akordua birrës Elbar për cilësinë superiore, imazhin unik, paketimin dhe shijen e birrës. Ky vlerësim për birrën shqiptare Elbar na bën të gjithëve krenarë.

Çmimi ndërkombëtar, i cili është ndër më të rëndësishmit në arenën e industrisë ushqimore, vlerëson përbërësit e pastër, procesin e fermentimit të kujdesshëm dhe shijen unike të birrës Elbar, e cila u dallua mes qindra birrave pjesëmarrëse nga mbarë bota, duke tërhequr vëmendjen e jurisë me karakteristikat e saj unike.

Çmimi prestigjioz Monde Selection 2024 iu dorëzua përfaqësuesve të kompanisë në ceremoninë madhështore të ndarjes së çmimeve në Vienë. "Jemi të emocionuar dhe krenarë që Birra shqiptare Elbar fiton këtë çmim të rëndësishëm i cili reflekton përkushtimin maksimal për të ofruar produkte me cilësi superiore në tregun shqiptar, por edhe dashurinë e konsumatorëve që e kanë zgjedhur tashmë Elbar si birrën e tyre të preferuar. Mirënjohje! - u shprehën përfaqësuesit e kompanisë ndërsa morën Medaljen e Artë.



Medalja e Artë jo vetëm konfirmon pozicionin e birrës Elbar si lider në industrinë e birrës në Shqipëri, por është edhe një krenari shqiptare pasi Elbar konkurroi përkrah qindra konkurrentëve nga e gjithë bota dhe u vlerësua nga një juri ndërkombëtare. Birra shqiptare Elbar prodhohet në fabrikën e Glinës me standardet më të larta të prodhimit, me teknologjinë më moderne nga Kronos. Në këto 9 vite të prezencës së saj në tregun shqiptar, Birra Elbar, ka ditur të fitojë vëmendjen dhe zemrat e konsumatorëve që e kanë bërë tashmë pjesë të tryezave familjare dhe festave mes miqsh kudo në Shqipëri falë prezencës së saj në çdo cep të vendit, por edhe përmes 'FESTËS SË MIQËSISË' që prej 9 vitesh shëtit çdo verë në shumë qytete shqiptare duke sjellë tingujt e muzikës së zgjedhur, shumë argëtim dhe surpriza bashkë me shijen e pakrahasueshme të birrës Elbar.

Birra Elbar është pjesë e portofolit të Aagna Group, kompania lider në tregun shqiptar në industrinë e produkteve ushqimore. Aagna Group ka pjesë të misionit të saj përkushtimin maksimal ndaj klientëve dhe konsumatorëve, duke ofruar vazhdimisht produkte cilësore, risi dhe shërbim superior.

Birra Elbar, krenari Shqiptare!



**FITUESE E MEDALJES SË ARTË**  
MONDE SELECTION®

# “Festa e Miqësisë”, me miqtë kudo në Shqipëri!



## FESTA e MIQËSISË

Riti më miqësor i verës!



**F**esta e Miqësisë, si çdo verë për 9-vjet radhazi, udhëtoi në shumë qytete të Shqipërisë për 31 ditë, duke dhuruar një eksperiencë unike për të gjithë pjesëmarrësit.

Birra Elbar me miqtë dhe muzikën e përzgjedhur nga këngëtarë të mirënjohur si Anxhela Peristeri, NRG Band, Three Dots, West Side Family, Vesa Luma, Mateus Frroku, Offchestra, etj, gjallëruan mbrëmjet e shumë qyteteve duke kulmuar në datat 6-8 Shtator në kryeqytet, në sheshin Skënderbej në një atmosferë të jashtëzakonshme.

“Me lojëra, shorte dhe argëtim pa fund, Festa e Miqësisë dhuroi momente të paharrueshme për të gjithë, në shoqërinë e birrës Elbar. Tradita e kësaj feste do të vazhdojë edhe në vitin 2025, duke ju ofruar mbrëmje të bukura verore.



# Heineken

## SHPËRBLËN KONSUMATORËT ME NJË EXPERIENCË UNIKE!

Falë Heineken, birrës së tyre të preferuar, 20 konsumatorë shqiptarë shijuan një experiencë fantastike në ndeshjen gjysmë finale të UEFA Champions League, Real Madrid vs. Bayern Munchen.

Përgjatë gjithë sezonit të UEFA Champions League, Heineken shpërbleu çdo javë konsumatorët, me dhurata të këndshme si çantë dhe top futboll, frigorifer të mbushur me birrë, por më fatlumet ishin ata që fituan dhuratë biletën dhe udhëtimin për të ndjekur live në Stadiumin Santiago Bernabeu, super ndeshjen mes Real Madrid dhe Bayern Munchen.


Secili nga konsumatorët e Heineken ka patur mundësinë të bëhej pjesë e promovimit, duke gjetur kodin poshtë tapës së shishes dhe duke e regjistruar atë tek adresa [www.heineken.com](http://www.heineken.com). Është kjo një lojë e bukur argëtuese që Heineken zhvillon tashmë prej vitesh në tregun shqiptar.

Gjithashtu pjesa tjetër e fituesve u zgjodh në shorteun e organizuar në datën 18 Prill në Plaza, në një Event Special të Heineken. Nën tingujt e muzikës fantastike të bandës Offchestra dhe plot performancave të tjera artistike, konsumatorët besnikë të birrës Heineken shijuan një mbrëmje të veçantë.

Për 20 fituesit e Heineken, kjo eksperiencë do të mbetet e paharrueshme dhe unike.

"Ishin emocionet më të bukura që kam përjetuar ndonjëherë. Të shikoja skuadrën time të preferuar live në stadium. Faleminderit Heineken për këtë mundësi", u shpreh një nga fituesit e promovimit të Heineken.

Heineken, birra numër 1 në botë, sponsor zyrtar i UEFA Champions League, platformës botërore më premium të futbollit, çdo sezon të UEFA Champions League sjell në Shqipëri surpriza pa fund për konsumatorët e saj sportdashës dhe jo vetëm.



# PAMJE E RE E NJËJTA SHIJE FANTASTIKE



## EPOKA E RE E PEPSI FILLOI ZYRTARISHT!

**K**ëtë vit, për herë të parë pas katërmëdhjetë vjetësh, festuam një ridizenjim tërësor global. Me një komunikim të jashtëzakonshëm dixhital, prezantuam pamjen dhe identitetin tonë vizual në mbi 120

tregje në mbarë botën. Nisëm një udhëtim të ri sfidues në kërkim të kënaqësisë, duke ftuar fansat tanë që të mos rreshtin së zbuluari, përjetuari dhe shijuari më shumë. Si pjesë e një epoke të re, do të lëvizim me ritmin e kohës, duke ofruar atë për të cilën njerëzit janë të etur - produkte inovative dhe bashkëpunime ikonike. E njëjta shije fantastike që konsumatorët preferojnë... për të shoqëruar eksperiencën akoma më epike në muzikë, sport dhe kulturë! #thirstyformore

# KUR KA LAY'S, KA FUTBOLL

NO LAY'S, NO GAME





# Festa e Birrës në Korçë



“Festa e Birrës” në Korçë në datat 14-18 Gusht 2025, ofroi një eksperiencë të bukur për konsumatorët shqiptarë si dhe shumë turistë që vizituan Shqipërinë këtë verë. Agna Group mori pjesë me Elbar, birrën shqiptare që na bën krenar si dhe me birrën Amstel, sepse kështu na pëlqen 😊.

5 netë festë, shqiptarë dhe të huaj u argëtuan nën tingujt e këngëtarëve të mirënjohur të muzikës së lehtë dhe popullore.



## FITO ME 7DAYS

Brandi 7DAYS zhvilloi fushatën promovionale “FITO ME 7DAYS” nga data 9 Shtator deri më 20 Tetor 2024, duke kombinuar muzikën, argëtimin dhe udhëtimet për t’u ofruar konsumatorëve eksperiencën të bukur.

Fituesit u shpallën çdo javë në faqen zyrtare 7days.al, ku konsumatorët patën mundësinë të fitonin 50 kupona me vlerë 7,000 Lekë dhe 35,000 Lekë, si dhe një SUPER çmim: një udhëtim çift dhe akses VIP në UNTOLD Festival në Dubai.





Në kuadër të inovacionit dhe kreativitetit, Aranxhata ishte partner zyrtar i Junction X Hackathon Tirana me sfidën unike "Gamify Your Sip". Në këtë event, të rinjtë zhvilluan një aplikacion celular inovativ, duke përdorur kode unike të vendosura në kanaçet e Aranxhatës, për të transformuar këtë pije në një përvojë lojërash emocionuese.

Përdoruesit mund të skanojnë kodet për të krijuar llogari, të luajnë lojëra me nivele të shumta dhe të fitojnë çmime të ndryshme. Sa më shumë kode të vendosin, aq më shumë rriten shanset për t'u bërë fitues!


Kjo nismë jo vetëm që inkurajoi inovacionin në teknologji, por Aranxhata gjithashtu solli një tjetër dimension të përfshirjes dhe argëtimit për të gjithë pjesëmarrësit.



## ARANXHATA NË "TIRANA ART FESTIVAL"



Aranxhata mbështeti edicionin e parë të Tirana Art Festival për zbulimin dhe promovimin e talenteve të reja në fushën e artit në Tiranë. Ndërsa pasioni për artin bashkoi të rinjtë, Aranxhata solli nota freskie në këtë përvojë artistike të paharrueshme, duke e bërë çdo moment edhe më të gëzueshëm!



KRIJO, LUAJ DHE SHIJO ARANXHATA

# LOTARIA

## Duel



**P**ërgjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2024, Duel zhvilloi një fushatë promocionale të suksesshme, duke shpërblyer klientët e tij besnikë me dhurata fantastike. Pas blerjes së produkteve të përzgjedhura, konsumatorët regjistruan të dhënat e tyre në faqen zyrtare [www.duel.al](http://www.duel.al).

Fituesit e dhuratave, si televizorë Samsung 65", tharëse/ lavatriçe rrobash/ fshesa robotike Gorenje, tharëse flokësh/ fshesë me korent Dyson V15, u përzgjedhën çdo të premtë përmes një shorti transparent, duke u dhuruar fituesve një fundvit të veçantë dhe të gëzueshëm.

**SALTED CARAMEL & AUSTRALIAN MACADAMIA**

**Nuii**  
ICE CREAM ADVENTURE™

&  
**JASON MOMOA**

Jason Momoa, aktori karizantik dhe energjik, i famshëm për rolet e tij ikonike në filma dhe seriale si Aquaman, Game of Thrones, dhe Dune ishte ambasadori i markës NUII për fushatën 2024. Jason Momoa është më shumë sesa një aktor i talentuar; ai është një frymëzim për ata që kërkojnë të jetojnë me guxim, pasion dhe autenticitet.

Ai përfaqëson thelbin dhe vlerat që NUII mishëron. Pasioni i tij për udhëtimet, aventurat dhe natyrën, përputhet në mënyrë të përsosur me misionin e NUII: t'u ofrojë konsumatorëve një përvojë më të egër dhe të veçantë përmes shijes unike të akulloreve.

Zgjidhni aventurën tuaj të radhës!


## KUJDES DHE KOMODITET PËR PRINDËRIT DHE FOSHNJAT

**Q**ë prej janarit të vitit 2024 në Agna Group është krijuar një department i ri që ka në fokus produkte që ju vijnë në ndihmë prindërve të rinj për kujdesin ndaj fëmijëve. Kjo iniciativë strategjike synon të sjellë në tregun shqiptar marka dhe produkte të reja duke diversifikuar kanalet e shpërndarjes, për të qenë më pranë prindërve të rinj, për ti ndihmuar në çdo hap të kujdesit për fëmijët. Para-farmacia, do të ndërtojë partneritete të reja me farmacitë dhe dyqanet e fëmijëve për t'i bërë këto produkte më të aksesueshme për konsumatorët.

Markat, Chipolino dhe Nuvita, ofrojnë zgjidhje cilësore, komode dhe inovative për nevojat e përditshme të kujdesit ndaj foshnjave dhe fëmijëve.

**nuvita**   
simplify your life.

**CHIPOLINO**



**agna**  
group

*Ju urojmë*  
**GËZUAR FESTAT!**





### NESTLÉ CLASSIC MILK CHOCOCHOLATE 60GR

Çokollata Nestlé e pasur me qumësht.  
Nestlé, mjeshtri i çokollatës, ju sjell lumturi momenteve tuaja.



### KITKAT BALL MILK 140 & 36GR

Një përvojë e re Crunchy.  
Shijoni tophat me çokollatë.



### NESTLÉ CRISPY WAFER 27GR

Çokollatë me vafer, e përkryer për momentet tuaja.  
E pështatshme të konsumohet në lëvizje shoqëruar me kafënë tuaj.



### KITKAT CHUNKY DOUBLE

KitKat Chunky Crunchy Doppio Çokollatë krenohet me një vafer krokant me çokollatë të veshur me një përzierje të përsosur të çokollatës së butë me qumësht.



### NESTLÉ DAMAK ALA COUNTLINE 30GR

Vaferat Nestlé Ala Pistaccio janë të mbushur me aromën e pasur të fistikëve. Çdo kafshatë ofron një kërcitje të kënaqshme, falë shtresave të vaferit të pjekur në mënyrë perfekte.



### NESQUIK WAFER

Vafer Nesquik është një shije unike e përbërë nga një kombinim i çokollatës së shijshme Nestlé me shumë qumësht dhe vafera krokantë.



### NESCAFÉ INTENSO BEAN 1 KG

Të gjithë e meritojnë një filxhan kafe, Nescafé të shkëlqyer. Një përzierje intensive dhe e balancuar, me një blend mesatar, që ofron shije çokollate, nota frutash dhe një nuancë të ëmbël erëzash. Kokrra cilësore të përzgjedhura me kujdes nga profesionistë, ofrojnë një produkt perfekt që krijon momente magjepsëse, ideale për kafën në punë apo për të kaluar kohë cilësore me miqtë.



### METAXA OUZO

Një aperitiv grek me shije Anise, që sjell një aromë mesdhetare për adhuruesit e koktejleve. Me përbërës botanikë si kopra, koriandra dhe Anise, ofron një shije të thellë dhe komplekse, perfekte për servirje tradicionale dhe kokteje moderne. Sugjerohet të shijohet i ftohtë ose i përzier me ujë të ftohtë, duke lëshuar vajrat aromatikë dhe krijuar një turbullirë unike.



### SHIJONI AKULLORET TUAJA TË PREFERUARA

Sezoni veror ka sjellë shije të reja të akulloreve nga brandet Nirvana, NUII, KitKat, Milka dhe Toblerone. Akulloret tuaja të preferuara tani i gjeni në versione praktike si multipack dhe tub, për një eksperiencë plotë shije.



### DUEL ZBUTËS SEZONAL

Duel rinovoi dhe zgjeroi gamën e produkteve, duke sjellë inovacion me lançimin e linjës "Limited Edition" të zbutesit Duel 1.6L, me katër aroma unike të frymëzuara nga stinët. Secila aromë sjell një përvojë të freskët dhe unike, duke lejuar eksplorimin e nuancave të reja.



### DUEL PLUHUR

Duel prezanton një risi në Detergjentin Pluhur, duke modernizuar paketimin dhe përqendruar më tepër formulën. Dizajni i ri pasqyron angazhimin për cilësi dhe inovacion, ndërsa formula e përqendruar siguron pastrim më efektiv me më pak sasi produkti. Ky inovacion siguron një përdorim më efikas dhe të këndshëm të produktit në çdo rast.



# FESTAT SHIJOJNË MË SHUMË ME



## Colour Day Festival

### ARANXHATA E NGJYRAVE NË COLOUR DAY FESTIVAL

Aranxhata ishte një nga protagonistët e festës më të madhe të ngjyrave në Tiranë, Colour Day Festival, duke sjellë freskinë dhe shijet e saj të dashura për të gjithë pjesëmarrësit.

Si sponsori zyrtar i këtij eventi, Aranxhata kontribuoi në atmosferën e gjallë të festivalit me një mori aktivitësh argëtuese dhurata dhe hapësira të dedikuara për pushim e relaksim, duke u ardhur pranë mijëra të rinjve që kërcenin e festonin nën qiellin e mbushur me ngjyra.

Më shumë se 60.000 pjesëmarrës shijuan energjinë e festivalit, duke e bërë këtë ditë një festë të paharrueshme, të mbushur me freskinë e veçantë të Aranxhatës dhe kujtime që do të mbesin gjatë në mendjet e tyre! Ashtu si dikur, shijonim aranxhatën që e dëshironim kaq shumë, e luanim me njëritjetrit, ashtu edhe sot, në evente të mëdha si Color Day, apo aktivitete të vogla të jetës së përditshme, shijojmë Aranxhata e ndjehemi përherë fëmijë, me momente nostalgjike, apo duke i marë maksimumin momentit.



### PEPSI ZBULON PAMJEN E RE NË COLOUR DAY FESTIVAL

Colour Day Festival këtë vit nuk ishte vetëm një spektakël ngjyrash, por një ngjarje ku Pepsi shpalosi identitetin e ri visual para më shumë se 60.000 pjesëmarrësve. Festivali, i njohur për atmosferën e tij të gëzueshme, shumëngjyrëshe shërbeu si sfondi i përsosur që Pepsi të zbulonte imazhin e ri duke krijuar përvoja të paharrueshme për pjesëmarrësit nëpërmjet aktivizimeve të shumta dhe tërheqëse.

Siç pritej, festivali ishte një eskperiençë e jashtëzakonshme për të gjithë pjesëmarrësit, duke e shndërruar sheshin Skënderbej për orë të tëra në një telajo, ndërsa Pepsi tregoi edhe njëherë sesi një brand mund të angazhohet në mënyrë origjinale dhe kuptimplotë me audiencën në eventin e të gjitha ngjyrave dhe tingujve.



## SHQIPËRIA NË KONKURSION NDËRKOMBËTAR "METAXA 12\*"



**K**onkursi "Metaxa 12\* Competition" u organizua në Tetor 2024 në Tiranë, duke mbledhur bartenderat më të njohur të kryeqytetit. Pas një gare

plotë pasion, fitues u shpall Mariol Gjata, i cili përfaqësoi Shqipërinë në fazën ndërkombëtare të konkursit "Metaxa 12\* Competition", i cila u mbajt në muajin Nëntor në Athinë, Greqi.

Taste the  
unexpected

**METAXA**  
TWELVE

# Flamin' Hot®

**GUXO TË DIGJESH!**

## SHIJA E RE FLAMIN' HOT

**S**hija Flamin' Hot, një trend global tani i pranishëm edhe në Shqipëri! Hulumtimet tregojnë se shijet djegëse janë më të pëlqyerat nga të rinjtë, të cilët kërkojnë të përjetojnë aventura të reja dhe të guximshme me markat e tyre të preferuara.

Lay's dhe Doritos, me shijen e zjarrtë të Flamin' Hot, u ofrojnë konsumatorëve një rrugëtim të paharrueshëm në botën e shijeve të guximshme.





## RECETË FESTIVE ME GLINA TONIC

Një cocktail me Glina Tonic është zgjedhje e bukur për të festuar këtë periudhë magjike. Glina Tonic është këtu për të sjellë më shumë shije dhe gëzim në festat tuaja. Gëzuar Krishtlindjet dhe një Vit të Ri plot mundësi e lumturi!

Ja një recetë dhuratë për një cocktail të paharrueshëm.

- "Winter Wonderland Tonic"**
- Përbërësit:**
- 50 ml vodka
  - 100 ml Glina Tonic
  - Kanellë
  - Portokall të freskët
  - Akull



## SPECTAPOLIS TIRANA ARENA E SPEKTAKLIT 2024



**N**ë zemrën e Tiranës, aty ku ritmet e muzikës dhe atmosfera festive gërshetohen në mënyrë të përsosur, Spectapolis u shndërrua në një arenë të mirëfilltë spektaklesh këtë verë.

Nga qershori deri në gusht, mbi 100,000 vizitorë përjetuan magjinë e një eventi që i dha kryeqytetit energji, tinguj të paharrueshëm dhe kujtime unike.

Dy skenat e festivalit pritën disa nga yjet më të mëdhenj të muzikës vendase dhe ndërkombëtare. Jason Derulo, Giusy Ferreri, Gipsy Kings, Konstantinos Argiros, Capital T, Vedat Ademi, Dren Abazi dhe shumë të tjerë magjepsën publikun me performancat e tyre të jashtëzakonshme.

Spectapolis ishte një udhëtim kulturor, një vendtakim për adhuruesit e futbollit, artit, dhe argëtimit. Programi i larmishëm, i përshtatur për çdo moshë dhe shije, transformoi Tiranën në kryeqytetin e padiskutueshëm të festës gjatë muajve të verës.

Sponsorët kryesorë – Heineken, Pepsi, dhe Aranaxhata – ishin aty për të sjellë freski dhe shije gjatë netëve të gjata plot argëtim.





# FIZZ THE SEASON



L'ITALIANA AUTENTICA

## NJË UDHËTIM UNIK ME BIRRA MORETTI

**B**irra Moretti solli një eksperiencë të paharrueshme për konsumatorët e saj, duke kombinuar shijen e mrekullueshme të birrës me artin italian. Për çdo blerje të paketimit me 4 shishe në rrjetin Spar, konsumatorët përfituan një gotë unike të stilizuar me rajonet dhe qytetet më të bukura italiane.

Gotat ishin të dizajnuara për të sjellë në duart e konsumatorëve magjinë e Toskanës me tarracat plot histori, arkitekturën e lavdishme të Romës, elegancën klasike të Sienës dhe peisazhet mbreslënëse të bregut të Amalfit.

Me çdo gllënjë nga gotat e Birra Moretti, nis një udhëtim i shijes autentike italiane, duke përjetuar një copëz të kulturës dhe pasionit të Italisë në çdo detaj.



Bashkë në Aktivitete  
**Kulturore**



Festivali i 20-të ndërkombëtar i vokalit operistik – Marie Kraja



Festivali Mbarëkombëtar i komedisë "KoKo Fest"



8OR Fest




IDFT "Disco foot"



Koncerti Olen Cezari, Tiranë



Koncert Alban Skënderaj, Gjirokastrë




Las Vegas Magic Festival



"Green Corner Kometa", UCL



"IHRFFA"- Edicioni 19-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut



Maratona "Këngë Mojë" 2024



"Mik Festival", Korçë



"Nona Fest" në Përmet



"MENEHUNE", Pepsi



Verë & Portokalle



"Klea Huta Summer Camp"



"Konferenca për marketingun dixhital, AllWeb Albania"



"Panairi Peshkimit", Sarandë



"Tirana Digital Nomad Festival"



"Tirana Street Food Festival (Set-Up)"



"Click Expo Group 2024"

# Bashkë në Aktivitete Sociale



Ceremonia e diplomimit, Universiteti UBT



"Dita e mbretit", Ambasada Holandeze



"Dita Ndërkombëtare e Yogës", Tiranë

# Bashkë në Aktivitete Sportive



"Beach Voley", Vlorë



Dyrrah City "Kampionati soccer"



Countdown event "Liga Unike, Federata shqiptare e basketbollit"



"Iron fist" Kampionati Ndërkombetar i boksit



"Maratona e Tiranës" edicioni i tetë



Gara me biçikleta, Kaninë, Vlorë



Kampionati Atletikës për fëmijë, Elbasan



"Half Marathon SKAMPA" Elbasan



"Maratona e Tiranës, në ditën e dëshmorëve"



"Kamza Marathon"



Maratona "Enkelana" në Pogradec



Maratona e fëmijëve, Berat



Kampionati Tenisit, Vlorë



Triathlon Vlorë



"Liga Gjergj Kastrioti voleyball", Korçë



Maratona e fëmijëve, Zvërnec



Parada e fëmijëve për 1 Qershorin, Vlorë




Tirana "Karate Champions"



Kampionati Judos



Titan Fights



Kampionati kickbox



NE DHE JU,  
GJITHMONË BASHKË

**HEINZ**  
ESTD 1869

## SI RIKTHIMI I KLASIKËVE PO NDIHMON **BRANDET** TË LIDHEN ME AUDIENCËN NË EPOKËN DIGJITALE



Në epokën e sotme, rikthimi i klasikëve është një fenomen që ka kapur çdo aspekt të kulturës popullore dhe është shndërruar në një strategji të fuqishme në marketingun digjital, veçanërisht në platformat sociale. Filmat, lojërat, muzika dhe librat rikthehen vazhdimisht, duke ofruar mundësi të reja për angazhimin e audiencës, kreativitetin dhe lidhjen e brandeve me konsumatorët në një mënyrë më inovative.

Një shembull i shkëlqyer është filmi "Dune 2", i cili ka shkaktuar një bum në rrjetet sociale dhe ka bashkuar audiencat e ndryshme, si të rinjtë që u mahnitën nga vizualet dhe ata që kishin nostalgji për versionin origjinal, duke krijuar një atmosferë diskutimi dhe përvojash të ndryshme.

Në këtë kontekst, rrjetet sociale janë një mjet i fuqishëm për angazhimin e audiencës. Hashtag-et dhe fushatat tematike si "#FriendsReunion" për serialin e njohur, mundësojnë krijimin e një bisedë kolektive që lidhet me rikthimin e titujve të njohur. Ky angazhim krijon mundësi të mëdha për brandet që duan të lidhin produktet e tyre me emocionet dhe pasionet e audiencës. Përbajtja vizuale luan një rol kyç në këtë proces, duke krijuar atmosferë pritjeje dhe duke stimuluar interesin të audiencës. Filmi "Freaky Friday" është një tjetër shembull, ku teaser-et dhe meme-t e shpërndara krijuan një lidhje të fortë me nostalgjinë e viteve të kaluara.

Influencuesit gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në këtë fushë. Ata përdorin platformat e tyre për të shpërndarë përmbajtje që lidhen me rikthimet dhe për të krijuar diskutime rreth titujve të njohur, duke stimuluar interesin e ndjekësve të tyre dhe duke përforcuar lidhjet e brandeve me konsumatorët.

Megjithatë, edhe pse marketingu digjital ofron mundësi të mëdha, ka edhe rreziqe të konsiderueshme.

Rikthimet e shumta mund të çojnë në lodhje të audiencës dhe në një rënie të interesit. Për më tepër, përmbajtja e dobët ose mosarritja e pritshmërive të fansave mund të ndikojë negativisht në reputacionin e markës. Gjithashtu, fushatat e mëdha për rikthime kërkojnë investime të larta, pa garantuar gjithmonë një kthim të mjaftueshëm për shpenzimet e bëra.

Si përfundim, rikthimi i klasikëve nëpërmjet marketingut digjital ka krijuar mundësi të jashtëzakonshme për angazhimin e audiencës dhe për lidhjen e brandeve me konsumatorët në një

nivel të ri. Megjithatë, është e rëndësishme që brandet të gjejnë një balancë midis nostalgjisë dhe inovacionit, për të ruajtur freskinë dhe interesin në këtë hapësirë të ngjeshur. Të ardhmen e këtij fenomeni do ta përcaktojnë ato brande që do të arrijnë të bashkojnë emocionet e së kaluarës me risitë e së ardhmes.

**Të ardhmen e këtij fenomeni do ta përcaktojnë ato brande që do të arrijnë të bashkojnë emocionet e së kaluarës me risitë e së ardhmes.**

## PARTNERITETE NË ZHVILLIM: AGNA GROUP & GROUPE SEB "KRUPS"

Groupe SEB, përmes markës "Krups", ka zyrtarizuar një partneritet të rëndësishëm me Nescafé Dolce Gusto, për shpërndarjen e makinerive të kafesë në dyqanet elektroshtëpiake në Shqipëri. Ky partneritet strategjik vjen si një hap i rëndësishëm për të rritur praninë dhe ndikimin e markës Nescafé Dolce Gusto në tregun shqiptar, duke ju ofruar konsumatorëve mundësi të reja për të shijuar kafënë me cilësi të lartë.

Groupe SEB, partneri më i madh global i makinerive të kafesë për Nescafé Dolce Gusto, do të sjellë përvojë dhe inovacion në këtë sektor. Ky bashkëpunim do të bëjë më të aksesueshme për konsumatorët kapsulat Nescafé Dolce Gusto në tregun e organizuar, por edhe në atë tradicional.



**EYES ON THE ROAD.  
EYES ON YOUR BRAND.**



[www.agnagroup.com](http://www.agnagroup.com)